

VENDIM
Nr. 460, datë 11.5.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV GRAMSHI”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 162 të KKRT-së, të vendimit nr.434, datë 21.3.2006 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr. 004/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “Kosturi” sh.p.k. për televizionin “TV Gramshi”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj